

Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit

Koncepti mbi mendimin kritik dhe strukturën ERR

Të menduarit në mënyrë kritike, si baza e kuptimit të informacionit është pika e nisjes në procesin e nxënjes. Zhvillimi i të menduarit në mënyrë kritike përfshin thithjen e ideve, shqyrtimin e tyre, ekuilibrin kundrejt pamjeve të gabuara. Të menduarit kritik është një proces kompleks i integritetit të ideve, shqyrtimit të burimeve në mënyrë krijuese. Është një proces njohës, veprues dhe ndërrveprues që ndodh në mjaft nivele të të menduarit.

Aftësia për të menduar në mënyrë kritike në procesin e të nxënës, pavarësisht nga fusha, i lejon nxënësit të njohin dhe të ndërtojnë argumente dhe hipoteza të shëndosha dhe të vlerësojnë përfundimin. **Të menduarit kritik është një proces i reflektimit të arsyeshëm mbi bazën e pohimeve.** Për të arritur këtë duhet më shumë aftësi, shumë njohuri dhe intiligjencë.

Faza e parë: Evokimi, struktura ERR

Kjo u kërkon nxënësve që të japin një listë idesh rreth një teme. Mësuesi nxjerrë disa mendime nga nxënësit, duke i pyetur rreth ideve që nuk janë diskutuar, por që kanë lidhje me procesin e të lexuarit. Roli i mësuesit në këtë fazë është të drejtojë, të kuptojë mendimin e nxënësve dhe t'i dëgjë ata me vëmendje. Kjo fazë ka rëndësinë e saj, pasi përfshin nxënësit në një veprimtari për të kujtuar njohuritë dhe për të filluar që të mendojnë për mësimin e ri. Kur njohuritë e ara janë të qëndrueshme, atëherë informacioni i ri kuptohet më lehtë. Nëse ndodh pamundësia e lidhjeve të këtyre njohurive, atëherë harrohet lehtë. Vlerësimet e kësaj faze janë: jo veëm shërben si urë lidhjeje mes informacioneve, por edhe si ndreqje keqkuptimesh, arsyetimesh të gabuara që zgjidhen pa një shqyrtim aktiv të njohurive. Një tjetër vlerësim është realizimi i një veprimtarie aktive duke mënjeluar pasivitetin e nxënësve të dobët. Si rezultat i kësaj pjesëmarrjeje ndërgjegjësohet veprimtaria në të menduarit me shkrim dhe me gojë. Duke i bërë arsyetimet më të qarta.

Faza e dytë: Realizimi i kuptimit

Kjo fazë ka për qëllim të mbajë ndezur ose të ruajë interesin e treguar në fazën e parë. Në këtë fazë nxënësi bie në kontakt me informacionin e ri dhe ndikimi i mësuesit tek nxënësi është i pakët. Nxënësit e mirë arrijnë të

konceptojnë të kuptuarit si një informacion të ri, bëjnë pyetje, kërkojnë sqarime, ndërsa të dobëtit kalojnë në arsyetimi të pavetëdijshme.

Faza e tretë: Reflektim

Kjo fazë lihet shpesh në harresë nga mësuesi. Ajo synon në të mësuarit e qëndrueshëm, në konsolidi të informacinit të ri si dhe të ristrukturojmë skemat për t'i përshtatur konceptet e reja. Gjatë kësaj faze arsyetimi është i qëndrueshëm, kur informacioni është i vendosur brenda një struktur dhe një përmbajtjeje të kuptueshme. Në këtë fazë realizohet shkëmbimi i ideve, ekspozohen një mori ndërtimesh që duhen marrë parasysh dhe kështu u lihet nxënësve më tepër hapësirë në diskutim.